FJALORI I TERMAVE TË DHUNËS ONLINE

DHUNA DIGJITALE

Çdo akt i dëmshëm që kryhet përmes teknologjisë dhe që mund të çojë në dëmtim fizik, seksual, psikologjik, social, politik ose ekonomik, ose në shkelje të të drejtave dhe lirive.

Shembuj të kësaj dhune janë:

• Gjurmimi i vendndodhjes përmes aplikacioneve, pa marrjen e pëlqimit
• Dërgimi i një numri të madh mesazhesh urrejtëse
• Dërgimi i mesazheve kërcënuese përmes internetit
• Postimi i fotografive private ose intime pa marrjen e pëlqimit
• Dërgimi i pamjeve ose mesazheve seksuale të padëshiruara
• Përdorimi i profileve të rreme për të përndjekur ose për t'u paraqitur si dikush tjetër

Dhuna virtuale është reale

ABUZIMI NËPËRMJET PËRDORIMIT TË PAMJEVE

[Që shpesh quhet pornografi për hakmarrje ose shpërndarja e fotove të një personi të zhveshur] Shpërndarja ose kërcënimi për shpërndarjen e pamjeve intime, të marra me ose pa pëlqim, me qëllim turpërimin, stigmatizimin ose dëmtimin e personit në foto.

Shembuj të kësaj dhune janë:

• Përdorimi i pamjeve seksuale për qëllime zhvatëse
Kur dikush i përdor fotot tuaja intime për t'ju bërë presion për foto ose video të tjera, ose për para apo favore seksuale të tjera.

• Deepfake [diipfeik] – montazh i rremë digjital
është një foto, video, ose regjistrim zanor që është ndryshuar me përdorim e IA për ta bërë të duket ose të tingëllojë real. Montazhet digjitale të rreme mund ta bëjnë dikë që të duket ose të thotë gjëra që nuk i kanë thënë apo bërë ndonjëherë.

• Cyberflashing [sajbërflashing] – dërgimi i pamjeve seksuale
Kur dikujt i dërgohen foto ose video digjitale seksuale të padëshiruara – zakonisht përmes aplikacioneve, mediave sociale etj., pa pëlqimin e personit të cilit i dërgohet.

• Upskirting [apskërting] – fotografimi ose filmimi i fshehtë nga poshtë fustanit/fundit
Marrja e fotove ose videove nga poshtë veshjes së dikujt, pa marrë lejen e tyre.

Dhuna virtuale është reale

SHKELJE TË PRIVATËSISË

• Doxing [doksing] – bërja publike e informacionit privat të një personi
Shpërndarja e informacionit privat të dikujt në internet – si adresa e shtëpisë, numri i telefonit ose adresa e email-it të tyre – pa marrë lejen e tyre, zakonisht me qëllim për t'i dëmtuar ose për t'i ngacmuar.

• Përvetësimi i identitetit
Paraqitja sikur je dikush tjetër në internet – duke përdorur emrin ose foton e atij personi – me qëllim dëmtimin ose mashtrimin e të tjerëve.

• Zoombombing [zumbombing] – ndërhyrja keqdashëse në videokonferenca
Ndërhyrja e paftuar në mbledhje/takime që zhvillohen në internet dhe shfaqja në to e materialeve me përmbajtje fyese – për të tronditur dhe për të penguar punën e pjesëmarrësve.

ABUZIMI DHE NGACMIMI SEKSUAL

• Joshja përmes internetit
Ndërtimi i besimit tek dikush me qëllim që ta shfrytëzosh ose abuzosh, shpesh për qëllime seksuale.

• Ngacmimi përmes internetit
Monitorimi apo kontaktimi i pareshtur i dikujt në internet për ta trembur ose frikësuar.

• Ngacmim seksual përmes internetit
Mesazhe ose veprime/sjellje seksuale të padëshiruara në internet që e bëjnë një person të ndihet i rrezikuar ose i poshtëruar.

NGACMIMI DHE ABUZIMI NË INTERNET

• Trolling [trolling] -
Postimi i komenteve apo i përmbajtjeve të caktuara thjesht për të provokuar, bezdisur ose për të përhapur urrejtje, shpesh me përdorim të profileve të rreme në internet.

• Gjuha e urrejtjes
Postimi i përmbajtjeve që sulmojnë ose kërcënojnë njerëzit për shkak të gjinisë, racës, besimit fetar ose ndonjë identiteti tjetër.

• Shpifja
Përhapja e informacionit të rremë në internet për të dëmtuar reputacionin e dikujt.

UN WOMEN

FOR ALL WOMEN AND GIRLS